

V E N D I M
Nr.26, datë 24.6.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Manol Konomi,	Anëtar i “““
Feti Gjilani,	Anëtar i “““
Veli Budo,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Franc Jakova,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, në datën 3.5.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.16 Akti, që i përket :

K E R K U E S : QATIP BASHO

SUBJEKT I INTERESUAR : PRESIDENTI I REPUBLIKES, në mungesë.

O B J E K T I :

Shfuqizimi i Dekretit të Presidentit të Republikës nr.1314, datë 8.1.1996.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr.1314, datë 8.1.1996, ka shkarkuar Z. Qatip Basho nga detyra e kryetarit të komunës të Selenicës në rrethin e Vlorës, për shkelje të rënda të ligjit.

Kërkesi Qatip Basho, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe në shpjegimet e tij ka pretenduar se :

- Dekreti i Presidentit të Republikës ka dalë pa pasur propozim nga Këshilli i Ministrave, procedurë e domosdoshme, në bazë të nenit 32 të Ligjit “Për organizimin e funksionimin e pushtetit lokal”;

- Nuk ka kryer shkelje të rënda të ligjit e as të Kushtetutës. Është e vërtetë që është marrë në përgjegjësi penale por ndjekjet penale kanë pushuar për mungesë të elementeve të veprës penale.

Në kundërshtim me sa pretendohet, është vërtetuar se Këshilli i Ministrave, me shkresën nr.3963, datë 30.11.1995, i ka propozuar Presidentit të Republikës shkarkimin nga detyra e kryetarit të Komunës, duke e motivuar këtë propozim. Sipas Këshillit të Ministrave, Z. Qatip Basho ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.7552, datë 10.6.1992 “Për organizimin e funksionimin e pushtetit lokal”. Ai nuk ka zbatuar apo ka ndryshuar vendimet e këshillit të komunës, nuk ka zbatuar vendimet e formës së prerë të gjykatës, ka shkelur dispozitat për urbanistikën si dhe një sërë dispozitash financiare.

Sa më sipër del e provuar nga materiali dokumentar i Prefekturës së Vlorës, nga dokumentet e dosjes hetimore nr.137 të vitit 1995 të Prokurorisë së Rrethit të Vlorës, të cilat u vunë në dispozicion mbi kërkesën e kësaj Gjykate. Në dosjen hetimore, si nga akt-kontrolli i shërbimit të Kontrollit të Shtetit, nga ekspertët kontabël etj., del se Qatip Basho me cilësinë e kryetarit të komunës ka kryer një sërë shkeljesh të rëndësishme ekonomiko-financiare. Hetimet kanë pushuar jo sepse shkeljet s’kanë ndodhur e financa e shtetit nuk është dëmtuar, por se një pjesë e mirë e dëmit ende ishte i kthyeshëm nga përfituesit. Vetë organi i hetimit, si organ i specializuar, konfirmon se shkelje ekonomiko-financiare ka pasur. Nëse këto shkelje janë ose jo të rënda, kjo nuk hyn në çmimin e Gjykatës Kushtetuese, por të organit që ka të drejtë të vlerësojë ato e të marrë masat përkatëse.

PËR KËTO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 9 e Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është i formës së prerë, përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 24.6.1996